

STATUTI

I PARTISË DEMOKRATIKE
TË ASHKALINJVE TË KOSOVËS

PDAK

I MIRATUAR ME DATEN 10 /06/2021



STATUTI

I PARTISË DEMOKRATIKE

TË ASHKALINJVE TË KOSOVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Emërtimi i partisë është: Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës.

(në tekstin e mëtojmë: PDAK) e cila është parti politike e qytetarve të lirë, e cila aktivitetin e vet politik e zhvillon në bazë të Statutit, të Programit dhe të dokumentave të tjera të miratuara në Kuvendin PDAK-së.

Neni 2

PDAK vepron në mënyrë të pavarur në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

PDAK organizon degë dhe zhvillon veprimtari edhe në shtetet e tjera.

Selia e PDAK është në Ferizaj.

Neni 3

PDAK-ën e përfaqëson Kryetari i PDAK-së dhe [REDAKTUAR] e në mungesë të tyre, e me autorizimin e kryetarit, e përfaqëojnë nënkryetarët, sekretari i përgjithshëm, përkatësisht antarët e Kryesisë së PDAK-së.

Neni 4

PDAK posedon vulën dhe simbolet. Formën, dimensionet dhe përmbajtjen e vulës dhe simboleve i përcakton Këshilli i Përgjithshëm i PDAK-së me propozimin e Kryesisë së PDAK-së. Vulën e vet e kanë edhe degët e PDAK-së. Ruajtja dhe përdorimi i vulës rregullohet me vendim të veçantë të Këshillit

edhe degët e PDAK-së. Ruajtja dhe përdorimi i vulës rregullohet me vendim të vaçantë të Këshillit Qendror të PDAK-së

Neni 5

II. KOMPETENCAT E PDAK -së:

Partia, në përputhje me ligjet dhe me Statutin e saj, përmes organeve të veta, në mënyrë të pavarur:

- 1. Nxjerr dhe ndryshon e plotëson Statutin e PDAK-së;*
- 2. Nxjerr planin financiar, raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare;*
- 3. Disponon mjetet dhe pasurinë e vet;*
- 4. Përcakton propozimin e simboleve, shenjave dhe festave kombëtare.*

Neni 6

III SYNIMET DHE VEPRIMTARIA E PDAK-së

Synimet dhe veprimtaria e PDAK-së përcaktohet me Programin e saj politik dhe me dokumentet e tjera të miratuara në Kuvendin e PDAK-së.

Neni 7

Aktiviteti i PDAK-së është publik .

PDAK mund të vendosë edhe për forma të tjera të veprimtarisë së saj politike.

Neni 8

Për synimet dhe veprimtarinë e saj PDAK informonë anëtarët dhe opinionin publik. PDAK mund të formojë shërbimin informativ dhe mund të organizojë edhe forma të tjera të informimit publik, si botime gazetash, buletinesh, revistash, librash e të tjera.

Neni 9

Anëtar i PDAK-së mund të bëhet çdo qytetar e qytetare mbi moshën 18-vjeçare që pranon Statutin dhe Programin e dokumentet e tjera të PDAK.

Antarësimi bëhet me deklaram të lirë, duke aderuar në PDAK.

Neni 10

IV ANËTARËSIMI

PDAK mund të ketë kryetar nderi. [REDAKTUAR] me propozimin e Kryesisë, e zgjedh Kuvendi i PDAK-së ose Këshilli i Përgjithshëm.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të PDAK:

- t'i përmbahet Statutit, Programit dhe dokumenteve të PDAK;*
- t'u përmbahet synimeve dhe vendimeve programore të PDAK;*
- të zgjedhet dhe të jetë i zgjedhur në organet e PDAK;*
- të informohet për veprimtarinë e PDAK*
- të ruajë nderin, autoritetin dhe interesat e PDAK-së;*
- të paguajë anëtarësinë. a/deget ne diaspor jan të obliguara te paguajn antarsin dhe te raportojn qendren , per gjdo te hyr. Me raport me shkrim .*

Neni 12

Anëtarësimi në PDAK pushon me:

- mosangazhimin dhe pengimin e aktivitetit të PDAK-së;*

Dorëheqja nga PDAK

Anëtari i PDAK mund të japë dorëheqje nga PDAK, me ç'rast duhet ta informojë me shkrim Kryesinë e degës së PDAK, e me kërkesën e tij, mund t'i lëshohet vërtetimi për dorëheqjen.

a -personat te cilet kan pozita te larta ne PDAK nese ata japin dorheqje duhet te dorzojn detyren me shkrimte shkarkohen ne kryesi dhe pastaj kryesija ja lëshon vendimin e dorheqjes ,nese jo atehere ngritet aktapadi gjygsore ndaj personit .

Shlyerjen nga PDAK e zbaton Kryesia e degës së PDAK.

Neni 14

V. ORGANIZIMI I PDAK

A. Kuvendi i PDAK

Kuvendi është organi më i lartë i PDAK.

- Kuvendi i PDAK:*
- miraton, ndryshon e plotëson Statutin, Programin dhe dokumentet e PDAK;*
- përcakton orientimet themelore të veprimtarisë politike të PDAK;*
- nxjerr rezoluta, deklarata dhe vendime;*
- zgjedh kryetarin e PDAK-së; - zgjedh Këshillin e Përgjithshëm të PDAK-së;*
- shqyrton dhe vlerëson punën e organeve të PDAK;*
- merr vendime për format e bashkëpunimit me subjektet vendore politike dhe asociacionet ndërkombëtare e të tjera politike;*
- Zgjedh Komisionin Statutar; - Zgjedh Komisionin për Mbikëqyrjen Financiare;*
- kryen edhe punë të tjera në pajtim me Statutin dhe Programin e PDAK.*

Neni 15

Kuvendin e PDAK-së e përbëjnë delegatët e zgjedhur në kuvendet e degëve.

Për numrin dhe kriteret e zgjedhjes së delegatëve vendosë Këshilli i Përgjithshëm, përkatësisht Kryesia e PDAK-së me autorizimin e Kuvendit.

Neni 16

Kuvendi i rregullit zgjedhor i PDAK-së mbahet një herë në 4 (katër) vjet.

Kuvendin e PDAK-së e konvokon Kryetari PDAK-së ose shumica e thjeshtë e Kuvendit,

Kryetari, Këshillit të Përgjithshëm ose shumica e thjeshtë e Kuvendit përcakton rendin e ditës së Kuvendit të PDAK,

Punën e Kuvendit të PDAK-së e drejton Kryetari i PDAK-së dhe Kryesia e punës, e cila zgjedhet në Kuvend. Me rregullore të veçanta që i miraton Kuvendi, përcaktohet mënyra e punës së Kuvendit.

Neni 17

Kuvendi i PDAK konvokohet edhe atëherë kur këto e kërkojnë 33% (1/3) e delegatve që e përbëjnë Kuvendin e PDAK .

Kuvendi i PDAK-së , i konvokuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të mbahet jo më vonë se brenda 60 ditësh nga dita e konvokimit.

Neni 18

Kuvendi mer vendim me shumicën e antarve të cilet jan present ne kuvend 51perqindte antarve te kuvendit

Votimi bëhet me ngritje dore . qe do thot votim i Hapur .

Konsiderohet i zgjedhur kandidati që ka fituar shumicën e votave të pranishmëve.

B. Këshilli i Përgjithshëm i PDAK:

Neni 19

Keshilli i pergjithshem nuk mund te mer vendim per shkarkimin e kryetarit .

Keshilli pergjithshem ka te drejt te thir dy here ne vit kuvendin e punes .

- propozon Projektstatutin dhe Projektprogramin e PDAK-së, si dhe plotësimin e ndryshimin e tyre;
- përcakton qëndimet dhe orientimet e Statutit dhe Programit të PDAK, si dhe plotësimin e ndryshimin e tyre;
- kujdeset për zbatimin e vendimeve të Kuvendit të PDAK-së;
- nxjerr dhe miraton normat e mirësjelljes dhe aktvendimet e organeve të PDAK-së;
- zgjedh komisionet, këshillat dhe grupet e punës dhe i përcakton detyrat e tyre;
- zgjedh dhe emëron kryeredaktorin dhe këshillin redaktues të gazetës dhe të publikimeve të tjera të PDAK-së
- emëron udhëheqësin e Qendrës për Informin të PDAK-së dhe për organizimin dhe zhvillimin e sakt në Kosovë dhe jashtë saj;

Lista per deputet

Renditja e listes per list parlamentare behet sipas pozitive te cilet i emron keshilli i pergjithshem i PDAK kryesin, psh kryetari nenkryetaret sekretaret dhe te tjeret me radh

- me propozimin e degëve të PDAK-së vazhdojn dhe plotsohen lista perfundimtare per zgjedhjet parlamentare.
- përcjell realizimin e politikës së PDAK-së të përfaqësuesve në organet e sajë në organet e Kuvendit të Kosovës dhe në organet e vetadministrimit local;
- merr vendim për shpalljen e zgjedhjeve në PDAK;
- shqyrton dhe miraton Raportin e punës së Kryesisë së PDAK-së;
- Aprovon Planin financiar dhe Llogarinë përfundimtare të PDAK-së dhe
- Raportin e punës ia paraqet Kuvendit të PDAK.

Neni 20

Këshilli i Përgjithshëm përbëhet nga anëtarët e zgjedhur në Kuvendin e PDAK. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm i zgjedh Kuvendi i PDAK-së nga lista me më shumë kandidate, e përbërë nga radha e delegatëve në Kuvend ose e anëtarëve të tjerë të PDAK-së

Pasi që Kryetari i PDAK-së të zgjedhet me votim publik, me zgjedhjen për kryetar ai konsiderohet edhe anëtar i Këshillit të Përgjithshëm.

Propozimin e listës për përbërjen e Këshillit të Përgjithshëm e bën Kryetari i PDAK-së në konsultim me Kryesinë e PDAK-së, me numër të kandidatëve aq sa është përbërja e Këshillit të Përgjithshëm. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm mund të rizgjedhen.

Në përbërje të zgjerruar të Këshillit të Përgjithshëm, me të drejta të barabarta, hyjnë edhe tre anëtarë që i propozon kolegji i degëve të PDAK-së jashtë Kosovës.

Neni 21

C. Kryetari i PDAK

Kryetarin e Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës e zgjedh Kuvendi i PDAK-së, mandati i kryetarit zgjatë 4 vjet.

- Kryetar i Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës mund të zgjedhet:

a) Personi i cili posedon jo më pak se përgatitjen shkollore universitare të drejtimit juridik, ekonomik ose të ndonjë fakulteti tjetër në të cilin ka diplomuar,

b) Një mandat i kryetarit të PDAK-së zgjat 4 vite

c) Kandidati për kryetar duhet të ketë provoj., anëtarësie, në PDAK jo më pak se katër (4) vjet radhazi (pa ndërpre).

a-1 Personat që janë ndjekur penalisht nga gjykatat dhe policija janë ndeshje me ligjet e Republikës së Kosovës nuk kanë të drejtë të kandidojnë për kryetar të subjektit politik

b/2 Kandidatët të cilët aplikojnë për kryetar të PDAK duhet të kenë vendbanim të përhershëm në KOSOVO.

Neni 22

Kryetari i PDAK-së

- e paraqet dhe e përfaqëson PDAK-ën

- e udhëheqë punën e PDAK-së dhe të organeve të saj;

- merr vendim për konvokimin e mbledhjeve të Kuvendit të PDAK-së

- e konvokon mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm dhe të kryesisë së PDAK-së,

- merr vendime dhe qëndrime politike në pajtim me Statutin dhe Programin e PDAK-së

- jep iniciativë për zgjedhjen e kuadrove të PDAK-së;

- autorizon persona të tjerë për përfaqësimin e PDAK-së, e në bazë të propozimit të Kryesisë, cakton përbërjen e delegacioneve të PDAK-së.

- kryetari nuk menxhon me mjetet financiare të buxhetit të PDAK-së.

Neni 23

D. KËSHILLI I MBIKËQYRJES

Kuvendi i Përgjithshëm në konsultim me Kryesinë e PDAK-së:

- zgjedh Këshillin e Mbiqëqyrjes, i cili kontrollon veprimtarinë financiare.

- material të PDAK-së;

- Këshilli i Mbiqëqyrje ka tre anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i PDAK me propozimin e Kryetarit të PDAK-së, për të cilin votojnë jo më pak se 1/3 e anëtarëve të Kuvendit të PDAK-së;

- për parregullësitë e punës së Kuvendit të PDAK-së dhe organeve të tjera, Këshilli i Mbiqëqyrjes i paraqet raport me shkrim Kryetarit të PDKA-së dhe Kuvendit të PDAK-së

- Këshilli i Mbiqëqyrjes nga radhët e veta zgjedh kryetarin e Këshillit.

Neni 24

Kryetari i PDAK-së zgjidhet në Kuvendin e PDAK-së.

Për mënyrën e zgjedhjes vendosë Kuvendi.

Për kryetar, mund të kandidojnë vetëm personat të cilët nuk kanë qenë të ndjekur penalisht ose për kundërvajtje së paku 5 vitet e fundit .

Në PDAK mund të aderojnë të gjithë ata që respektojnë Statutin, Programin dhe flamurin e simbolet e tjera të PDAK-së.

Neni 25

E. KRYESIA E PDAK

Kryesia është organ politik

-ekzekutiv i Këshillit të Përgjithshëm të PDAK-së.

Kryesia përbëhet nga:

- Kryetari

Zv kryetari

- 3 Nënkytarië –

Sekretari i Përgjithshëm

- Sekretari përherëshëm i kryetarit dhe për marrëdhënie me publikun

- Arkëtarë

- 13 anëtarë të tjerë të Kryesisë janë total

Kabinoti kryetarit të cilin e përcakton kryetari ,emrin ,;

- Kabinotin e kryetarit e cakton kryetari nga anëtarët e kryesisë prej 9 deri në 11 anëtarë;

- numri i anëtarëve të Këshillit të Përgjithshëm caktohet në Kuvend ,varësisht nga numri i degëve të PDAK-së.

Neni 26

Kompetencat e kryetarit

Me propozimin e Kryetarit;

Kryesinë e zgjedhë Këshilli i Përgjithshëm i PDAK-së

Zgjedhja e anëtarëve të Kryesisë bëhet me vota publike.

Me propozimin e kryetarit të PDAK-së.

Këshilli i Përgjithshëm zgjedh edhe,

1 zv kryetar me propozim të kryetarit të cilin e përcakton kryetari emrin .

3 nënkryetarë tjerë të PDAK-së

Zgjedh sekretarin e përgjithshëm të PDAK-së,

sekretarin për marrëdhënie me publikun dhe sekretarin organizativ;

Zgjedh arkatarin dhe një anëtarë tjetër për ekzekutivin e partisë.

Këshilli i Përgjithshëm mund të zgjerojë listën e Kryesisë së PDAK-së sipas kërkesave të degëve dhe kryesis.

Kryetari pezullon aktivitetin e degës e cila degë është në kundërshtim me programin e PDAK dhe shkarkon kryetarin e degës i cili nuk i përgjigjet kryesisë qendrore ,dhe nëse kemi të dhëna nga aktivistët e pdak se dega ka keqperdor detyrën apo ndonjë antar i degës .

Kryetari ka të drejtë të pezullon aktivitetin politik nëse dega pa lejen e kryesisë ka marrë vendim për ndonjë koalicion për zgjedhjet lokale .

Neni 27

Anëtari i Kryesisë mund të rizgjedhet

Në qoftese ndonjëri nga anëtarët e Kryesisë nuk është në gjendje ta kryejë detyrën e anëtarit,

Kryesia është e detyruar të kërkojë nga Këshilli i Përgjithshëm të bëjë shkarkimin e tij dhe të zgjedhë anëtar tjetër të Kryesisë.

Këshilli i Përgjithshëm i PDAK-së, në bazë të kompetencave nga neni 20, 21 dhe 26 të këtij statuti, mund të bëjë shkarkimin e anëtarit të Kryesisë apo Kryesinë në tërësi, po që se konstaton se puna dhe veprimet e tyre janë në kundërshtim me Statutin dhe me Programin e PDAK-së.

Neni 28

Kryesia e PDAK-së:

- e përfaqëson PDAK-në,

- në emër të PDAK-së merr vendime politike dhe vendime të tjera, po që se ato nuk janë në kompetencën e organeve të tjera të PDAK-së;

- kujdeset për zbatimin e vendimeve të veta dhe vendimeve e qëndrimeve të Kuvendit dhe të Këshillit të Përgjithshëm dhe të Kryetarit të PDAK-së;

- kujdeset për harmonizimin e punëve të degëve, të nëndegëve dhe aktivëve politike të PDAK-së, përcjell zbatimin e vendimeve të organeve të PDAK-së dhe merr vendime konkrete lidhur me organizimin dhe funksionimin e tyre;

- Kryesia rregullisht analizon dhe përcjell punën e çdo sektori të Kryesisë dhe për moskryerjen e punëve, kërkon përgjegjësinë e tyre;

- në raste të veçanta pezullon punën e ndonjë organi të dëmshëm për PDAK-en, Kryesinë e degës, të nëndegës ose të Aktivit politik, si dhe konvokon Kuvendin e degës, të nëndegës ose të Aktivit politik. Lidhur me vendimin e lillë , Kryesia e njofton Këshillin e Përgjithshëm;

- përgatitë Projektstatutin dhe Projektprogramin dhe dokumentet e tjera të PDAK-së; - i paraqet raport vjetor për punën e vet Këshillit të Përgjithshëm ,

- dy herë në vit paraqet raport për pasurinë e PDAK-së; i paraqet raport financiar edhe Këshillit të Përgjithshëm;

- me propozimin e Kryetarit të PDAK-së, Kryesia, nga radhët e veta, cakton sekretarët për sektore të veçanta të veprimtarisë së vet;

- Kryesia e PDAK-së dhe organet e PDAK-së për në mbledhet e veta rregullisht mbajnë proçesverbal;
- kryen edhe punë të tjera në pajtim me me Statutin Programin e PDAK-së;
- për punën e vet Kryesia nxjer rregullore të posaçme.

Neni 29

Punën e kryesisë e drejton Kryetari i PDAK-së ose zëvendëskryetari, e në mungesë të tyre, nënkryetarët ose Sekretari i përgjithshëm e zëvendsojnë Kryetarin e PDAK-së, me autorizimin e tij.

-Arkëtari i zgjedhur nga Këshilli i Përgjithshëm i PDAK-së është përgjegjës për financat dhe është i autorizuar për nënshkrime lidhur me çështjet financiare.

-arkëtari, me autorizimin e kryetarit të PDAK-së, tërheq mjete financiare nga buxheti PDAK-ës.

-Arkëtari mbanë ditarin e hyrje-daljeve financiare dhe parqet i raport financiar çdo tre muaj PDAK-së.

Neni 30

Zv kryetari ,

Ne munges te kryetarit zv kryetari ka te drejt te udheq punen e tij me leje te kryetarit .

Zv kryetari per gjdo marveshje konsultohet me kryetarin edhe kur kryetari esht jasht vendit .

Zv kryetari ka te drejt te udheq takimin e kryesis ne munges te kryetarit.

Zv kryetari esht i obliguar te konsultohet me kryesi dhe te udheq mledhjen e kryesis ne munges te kryetarit , por edhe kryetari kur te u jep autorizim e udheq kryesin sipas planprogramit te pđak ,mledhjet mujore

Zv kryetari nuk e ka te drejt te perdor vulen ne emer te kryetarit apo te neshkrun document pa autorizim te kryetarit .

F: Sekretari i Përgjithshëm

Sekretri i Përgjithshëm kujdeset për organizimin e punës së Kryesisë dhe për zbatimin e vendimeve të Kuvendit, të Këshillit të Përgjithshëm, të Kryetarit dhe të Kryesisë dhe udhëheq punët administrative të PDAK-së

Neni 31

G. Deputetët nga radha e PDAK-së

Kandidat për deputet/deputete për në Parlamentin e Kosovës, si dhe kandidatët për këshilltarë të komunave, duhet ta kenë jo më pak se përgatitjen e mesme shkollore. Anëtarët e PDAK-së, të cilët në kuadër të PDAK-së kanë fituar mandatin e deputetit/tes në Parlamentin e Kosovës, si dhe ata të cilët kanë fituar mandate në komuna, janë të obliguar të përfaqësojnë interesat e PDAK-së në bazë të Statutit, të Programit dhe të dokumenteve të PDAK -së.

- deputeti dhe këshilltarët marrin pjesë në grupe dhe komisionet parlamentare në kuadër të PDAK-es.*
- deputeti/deputetja nuk kanë të drejtë të anëtarësohen në ndonjë parti tjetër gjatë kohëzgjatjes së mandatit të fituar në kuadër të PDAK-së*
- po qe se deputeti/tja shkelë dispozitat e nenit 31 ë Statutit, përjashtohet nga PDAK.*

Neni 32

Kryetari i PDAK-së, përkatësisht Kryesia, kanë të drejtë të pezullojnë zbatimin e vendimeve të organeve të PDAK-së, të cilat janë në kundërshtim me ligjet, me Statutin dhe me Programin e me dokumentet e tjera të të PDAK-së.

Në raste të tilla janë të detyruar që menjëherë ta informojnë Këshillin e Përgjithshëm për të marrë vendimin definitiv.

Neni 33

H. Komisionet e PDAK-së

- 1. Komisioni Statutar;*
 - 2. Komisioni Disiplinor, dhe*
 - 3. Komisioni për Mbikëqyrje.*
- a) Komisioni Statutar është organ kolegjal dhe i pavarur i PDAK-së.*

b) Komisioni Diciplinor është organ i cili vepron në kuadër të PDAK-së.

-Komisionin Diciplinor e përbëjnë 5 anëtarë.

Komisioni ka kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin.

-Komisionin diciplinor e zgjedh Këshilli i Përgjithshëm.

- Kryetari i PDAK-së dhe arkëtarë nuk mund të zgjedhen anëtarë të Këshillit Diciplinor.

-Komisioni Diciplinor merr në pyetje aktivistët të cilët Kryesia ia ka paraqitur këtij komisioni për shkak të shkeljes së Statutit, Programit dhe dokumenteve të tjera dhe kanë bërë shkelje a veprime që janë në kundërshtim me normal dhe moralin e PDAK-së. -Shkeljen e Statutit dhe keqpërdorimet me paramendim, Komisioni Diciplinor me shkrim ia paraqet Këshillit të Përgjithshëm të PDAK-së.

Neni 35

c) Komisioni i mbikëqyrjes Komisioni mbikëqyrës (verifikues) për financa, është organ që vepron në kuadër të PDAK-së dhe zgjedhet nga Këshilli i Përgjithshëm i PDAK-së.

-Komisioni për Mbikëqyrjen përbëhet nga 5 anëtarë: kryetari, nënkryetari, sekretari dhe dy anëtarë.

-Komisionin e Mbikëqyrjes e zgjedh Kryesia dhe Këshilli i Përgjithshëm i PDAK-së.

-Arkëtarë dhe kryetari i PDAK-së nuk mund të zgjedhen anëtarë të Këshillit të Mbikëqyrjes.

-Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare dy here në vitë verifikon gjendjen financiare dhe lidhur me të i paraqet raport PDAK-së i cili shqyrton dhe miraton raportin.

-Komisioni i Mbikëqyrjes, nëse konstaton keqpërdorime financiare i raporton me shkrim Kryesisë e PDAK-së dhe Komisionit Diciplinor.

Neni 36

Komisioni Statutar ka për detyrë që të kujdeset për ligjshmërinë e punës së organeve të PDAK-së si dhe për harmonizimin e dispozitave të Statutit të PDAK-së me ligjet pozitive.

Po që se Komisioni Statutar konstaton se organi i PDAK-së ka marrë ndonjë vendim në kundërshtim me aktet e lartshënuara, menjëherë i bën vërejtje me shkrim atij organi dhe, njëkohësisht e njofton organin kompetent të PDAK-së, i cili, në bazë të dispozitave të këtij statuti, parandalon zbatimin e vendimit të tillë.

I. Degët, nëndegëtdheaktivet e PDAK-së

Degët

Degët e PDAK zgjidhen gjdo tri vite mandate tyre pushn pasi ti bejn trivite nga data e zgjedhjes dhe kan te drejt te rizgjedhen prap nese dega dhe nendega ja mundesojn nje gje te till .

Degët, nëndegët dhe aktivet politike të PDAK-së janë njësi të organizimit dhe të veprimit territorial të PDAK-së. Degët e PDAK-së janë njësi të organizimit në nivel të komunës, sipas ndarjes territoriale-administrative të Kosovës. Në bazë të vendimit të Kryesisë së PDAK-së, degë të PDAK-së formohen edhe në shtete të jashtme. Koordinimin e veprimit të tyre e bën Kryesia e PDAK-së dhe kolegji i degëve të PDAK-së, i cili përbëhet nga Kryetarët e degëve të PDAK-së në shtetet e jashtme. Kolegji i degëve e udhëheq Kryetari i Kolegjit, i cili zgjedhet nga përfaqësuesit e degëve të PDAK-së, në bazë të propozimit të Kryesisë së PDAK-së.

Për punën e vet dhe organizimin e brendshëm, kolegji i degëve miraton rregullore të posaçme , e cila duhet të jetë në përputhje me Statutin dhe Programin e PDAK-së. Degët e PDAK-së në diasporë, krahas respektimit të Statutit dhe Programit të PDAK-së, duhet të respektojnë edhe legjislacionin e vendit domicil.

Neni 38

Organet e degës së PDAK-së janë:

Kuvendi dhe Kryesia degës së PDAK-së. Kuvendin e përbëjnë delegatët e zgjedhur në kuvendet e nëndegëve.

Kuvendi i Degës së PDAK-së:

- nxjerr Programin e punës së degës;*
- shqyrton dhe miraton raportin e punës së Kryesisë;*
- zgjedh Kryesinë, kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin e Kryesisë së Degës;*
- zgjedh delegatët për Kuvendin e PDAK-së;*
- merr vendime dhe qëndrime të tjera politike, në pajtim me Statutin dhe Programin e PDAK-së.*

Degët nese jan ne kundërshtim me statusin e pdak kryetari me kryesin qendrore e pezullon aktivitetin dhe shkarkon degën , formion komision per formimin degeve te reja mbrenda 7 dite .

Neni 39

Degët, nëndegët dhe aktivitet politike të PDAK-së janë njësi të organizimit dhe të veprimtari territorial të PDAK-së. Degët e PDAK-së janë njësi të organizimit në nivelet komunale sipas ndarjes territoriale politike të Republikës së Kosovës. Degët e PDAK-së në diasporë krahas respektimit të programit dhe statutit të PDAK-së duhet të respektojnë edhe legjislacionin e vendit .

Neni 40

Kryesia e Degës është organ politik ekzekutiv i Kuvendit të Degës dhe kryesisë qendrore të PDAK-së dhe përgjigjet për realizimin dhe zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Degës si dhe të organeve më të larta, kryesisë së PDAK-së.

Kryesia mund të nxjerr vendime dhe qëndrime tjera politike si dhe vendime që kanë të bëjnë me territorin e Degës në të cilën vepron në pajtim me Statutin dhe Programin e PDAK-së.

Po ashtu, Kryesia e degës harmonizon punën e nëndegëve dhe të aktiveve të degës. Në rast të veçanta, Kryesia e degës, në marrëveshje me Kryesinë e PDAK-së, mund të marrë vendim për pezullimin e punës së kryesive të nëndegëve, përkatësisht të aktiveve politike, si dhe ta konvokojë kuvendin e nëndegës, përkatësisht të aktivitet politik.

Neni 41

Kryetarët e degëve doemos duhet të jenë njëzë të informuar dhe të kenë sëpakul përgatitjen e mesme shkollore .

Dëshminë e shkollës së mesme duhe dorëzuar Kryesisë Qendrore të PDAK-së.

Numri i anëtarëve të kryesisë së degëve caktohet varësisht nga numri i personave të anëtarësuar, por jo më shumë se 11 (njëmbëdhjet).

Kryesia e degës ka kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin, të cilët zgjedhen sipas procedurës së zgjedhjes së organeve të tjera të PDAK-së.

Neni 42

Në bazë të vendimit të Kryesisë së degës, nëndega e PDAK-së formohet në territorin e dy ose më shumë fshatrave, përkatësisht lagjeve të qyteteve.

Organet e nëndegës së PDAK-së janë Kuvendi dhe Kryesia.

Kuvendi i nëndegës zgjedh kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin e Kryesisë së nëndegës nga radhët e anëtarëve të Kryesisë si dhe delegatët për kuvendin e degës. Numri i delegatëve të Kuvendit të nëndegës caktohet varësisht numrit të anëtarëve të PDAK-së në nëndegë. Në të njëjtën mënyrë caktohet numri i anëtarëve të Kryesisë së nëndegës prej pesë deri në shtatë antarë.

Neni 43

Për punën e vet Kuvendi i nëndegës i paraqet raport dhe i përgjigjet Kuvendit të Degës.

Kryesia e nëndegës, në marrëveshje me Kryesinë e Degës, bën harmonizimin e punës së aktivëve politike si dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të organeve më të larta të PDAK-së.

Neni 44

Aktivitet politike të PDAK-së janë format themelore të organizimit të punës së PDAK-së.

Aktivi politik mund të organizohet edhe në vendet ku ekziston numër i vogël i anëtarëve të PDAK-së.

Në aktivet politike, ku numri i anëtarëve të PDAK-së është mbi 50 Kuvendi zgjedhet sipas procedurës për zgjedhjen e Kuvendit.

Në kuvend të degëve numri në kuvend do të jetë sipas antarsisë, se atë vendi nuk duhet të jetë më shumë se 51 dhe jo më pak se 31.

Votimi bëhet i hapur me ngrije dore, për dhe kundër.

Neni 45

Kryesia e aktivitet politik, e cila përbëhet prej më së shumti nëntë anëtarëve, ka Kryetarin, zëdhënësin dhe sekretarin, i cili gjedhet nga ana e Kuvendit të Aktivitet politik. Organet e Aktivitet politik të PDAK-së aktivitetin e vet e zhvillojnë në harmoni me organet e nëndegës, përkatësisht të Degës së PDAK-së dhe janë përgjegjëse para tyre

Neni 46

Kuvendi i degës, i nëndegës dhe i Aktivitet politik konvokohen dhe i aplikojnë në mënyrë identike dispozitat e këtij Statuti, që kanë të bëjnë me punën dhe me veprimtarinë e Kuvendit të PDAK-së.

Neni 47

Zgjedhja e delegatëve për Kuvendin e nëndegës dhe për Kuvendin e degës bëhet nga radha e delegatëve, përkatësisht e anëtarëve të Kuvendit të aktivitet politik, përkatësisht të nëndegës dhe nga anëtarësia e PDAK-së, të cilët e kanë vendbanimin në territorin e aktivitet politik

Kuvendi i degës së PDAK-së zgjedh delegatët për Kuvendin e PDAK-së nga përbërja e vet si dhe anëtarësia e gjerë territoriale e degës dhe jashtë saj.

Kuvendi i degës së PDAK-së nuk mund të zgjedh për delegat në Kuvendin e PDAK-së anëtarin e PDAK-së, i cili ka hyrë më parë në procesin zgjedhor në ndonjë kuvend të ndonjë dege tjetër të PDAK-së, pa marrë parasyshë rezultatin e votimit për të.

Neni 48

Me rastin e propozimit të secilit kandidat për t'u zgjedhur në organet e PDAK-së është e nevojshme të dihet deklarimi i tij paraprak për pranimin e kandidaturës. Deklarimi për pranimin e kandidatures bëhet gojarisht ose me shkrim. Në rastet kur kandidati i propozuar nuk deklarohet për kandidaturën, nënkuptohet se ka pranuar në heshtje.

PËRGJEGJËSIA DICIPLINORE

Neni 49

Anëtarin i PDAK-së është i detyruar t'i përmbahet Statuti dhe Programit të PDAK-së. Ndaj anëtarit të PDAK-së, i cili vepron kundër Statutit dhe Programit të PDAK-së dhe kundër vendimeve dhe qëndrimeve të organeve të PDAK-së, në të gjitha nivelet e organizimit të tyre, mund të shqiptohen masa disiplinore.

Masa e përgjegjesisë disiplinore është:

- përjashtim nga anëtarësia në PDAK.

Neni 50

Fillimi i procedurës për përgjegjësinë disiplinore mund ta bëjnë, në bazë të kërkesës me shkrim:

Kryesia e degës së PDAK-së për territorin e degës, përkatësisht Kryesia e PDAK-së për mbare organizimin e PDAK-së.

Fillimin e procedurës disiplinore, shkallën e përgjegjësisë disiplinore dhe shqiptimin e masës disiplinore e bën Komisioni Disiplinor, i caktuar nga nga Këshilli i Përgjithshëm i PDAK-së.

Personit ndaj të cilit fillohet procedura disiplinore duhet t'i mundësohet pjesëmarrja në procedurën disiplinore dhe mundësia e deklaramit dhe sqarimit mbi të gjitha faktet, provat dhe rrethanat të cilat i ngarkohen.

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor mund t'i parashtrohet ankesë Këshillit të Përgjithshëm, në cilësin e organit të shkallës së dytë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.

Vendimi mbi shqiptimin e masës disiplinore duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë udhëzimin për mjetin juridik.

Ankesa e pezullon përmbarimin e vendimit.

Vendimi i Këshillit të Përgjithshëm, i marrë lidhur me ankesën, është definitiv.

Neni 51

K. MANDATI I ORGANEVE TË ZGJEDHURA

Anëtarët e të gjitha organeve të zgjedhura të PDAK-së, zgjedhen për një mandat TREVJEÇARË, kurse revokohen, përkatësisht shkarkohen në mënyrën siç janë zgjedhur.

Në rastin kur ndonjëri nga anëtarët e Kryesisë së degës, nëndegës ose aktivit politik, nuk është në gjendje të kryej detyrën e anëtarit, ose jep dorëheqje, Kryesia përkatëse mund ta bëjë zëvendësimin me anëtarë tjetër nga radha e kandidatëve, i cili bëhet me pëlqimin e 1/3 së anëtarëve të kryesisë përkatëse.

L. MJETET FINANCIARE TË PDAK .

Neni 52

PDAK financohet nga të ardhura e buxhetit, anëtarësisë, kontributeve vullnetare ose donacioneve, nga veprimtaria botuese dhe nga format e tjera të veprimtarisë afariste dhe të marketingut.

Finacimi i pdak behet edhe nga personat te cilet zgjidhen nga subjekti politik i pdak te ati qendror dhe ati local te cilet punsohen ne emer te subjektit me nje antarsi te volitshem perte finansu subjekti

politik me rreze perqindje mujore 5 perqind apo me shum nese vendos ndryshe kryesia dhe keshilli qendror i subjektit politik .

Keshilli i Pergjithshem i PDAK-se, me vendim cakton shumen e anetaresisë per çdo vit kalendrik si dhe destinimet dhe menyren e shfrytezimit te tyre.

Për mjetet financiare të PDAK-së dhe menyren e shfrytezimit të tyre, Kryesia e PDAK-së i paraqet raport Keshillit të Pergjithshem dhe Kuvenditpunes të PDAK dy here ne vit PDAK ka xhirologarinë e vet.

Xhirologari mund të hapin edhe degët e PDAK-së

M. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 53

Ndryshimi dhe plotësimi i Statutit bëhet sipas procedurës për nxjerrjen e tij . Inisiativën për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Statuti mund ta jap

Kuvendi i PDAK-së, Kryetari, Keshilli i Pergjithshem, Kryesia e PDAK-së, Komisioni Statutar dhe 1/3 e Keshillit të Pergjithshem.

Neni 54

Në qoftëse për shkak të natyrës urgjente, rrethanave të jashtëzakonshme apo shkaqeve të tjera, ndryshimi dhe plotësimi i Statutit nuk mund të shqyrtohet o miratohet në Kuvendin e PDAK-së, ndryshimet dhe plotësimet i bënë Keshilli i Pergjithshem.

M. SHKAQET NGA TË CILAT PDAK PUSHON SË EKZISTUARI

Neni 55

PDAK mund të pushojë së ekzistuari po qe se për këtë vendosin 75% të anëtarëve të Keshillit të Pergjithshem ose vendoset në mbledhjen e Kuvendit të Pergjithshem.

Neni 56

Ky Statut hyn në fuqi dhe zbatohet nga dita e miratimit në Kuvendin e Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës.

STATUTI I PDAK-së

Kuvendi i VIII PDAK /s

11/06/2021

Kryetari VPDAK /s

